

STANDARDI NDËRKOMBËTAR I AUDITIMIT 500

EVIDENCA E AUDITIMIT

(Ka hyrë në fuqi për auditimet e pasqyrave financiare për periudhat që kanë filluar me datën 15 Dhjetor 2009 ose pas kësaj date)

PËRMBAJTJA

	Paragrafi (ët)
Hyrje	
Objekti i këtij SNA-je	1-2
Hyrja në fuqi	3
	4
Objektivi	
Përkufizimet	5
Kërkesat	
Evidenca e Nevojshme e Auditimit	6
Informacioni që Duhet të Përdoret si Evidencë Auditimi	7- 9
Zgjedhja e Elementeve që duhen Testuar për të Siguruar Evidencën e Auditimit	10
Moskoherencë ose Dyshime mbi Besueshmërinë e Evidencës së Auditimit	11
Zbatimi dhe Materiale të Tjera Shpjeguese	
Evidenca e Nevojshme e Auditimit	A1-A25
Informacioni që Duhet të Përdoret si Evidencë Auditimi	A26 –A52
Zgjedhja e Elementeve që duhen Testuar për të Siguruar Evidencën e Auditimit	A53 –A57
Moskoherencë ose Dyshime mbi Besueshmërinë e Evidencës së Auditimit	A58

Standardi Ndërkombëtar i Auditimit (SNA) 500, “Evidenca e Auditimit” duhet të lexohet i lidhur ngushtë me Standardin Ndërkombëtar të Auditimit (SNA) 200 “Objektivat e Përgjithshme të Audituesit të Pavarur dhe Kryerja e një Auditimi në Pajtim me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit”.

Hyrje

Objekti i këtij SNA-je

1. Ky Standard Ndërkombëtar i Auditimit (SNA) shpjegon se çfarë përbën evidencë auditimi në një auditim të pasqyrave financiare, dhe trajton përgjegjësinë e audituesit për të hartuar dhe kryer procedurat e auditimit për të marrë evidencë auditimi të mjaftueshme me qëllim që ai të jetë në gjëndje të nxjerrë konkluzione të arsyeshme mbi të cilat do të bazohet opinioni i audituesit.
2. Ky SNA është i zbatueshëm për të gjithë evidencën e auditimit të marrë gjatë kohës së zhvillimit të auditimit. SNA të tjerë merren me aspekte specifike të auditimit (për shembull, SNA315 (i rishikuar)¹), evidenca e auditimit për t'u marrë në lidhje me një çështje të caktuar (për shembull, SNA 570 (i rishikuar)²), procedurat specifike për të marrë evidencë auditimi (për shembull, SNA 520³) dhe vlerësimin nëse është marrë evidenca e nevojshme e auditimit (SNA 200⁴ dhe SNA 330⁵).

Hyrja në fuqi

3. Ky SNA ka hyrë në fuqi për auditimet e pasqyrave financiare për periudhat që kanë filluar me datën 15 Dhjetor 2009 ose pas kësaj date.

Objektivi

4. Objektivi i audituesit është të përcaktojë dhe të kryejë procedurat e auditimit në një mënyrë të atillë që t'i japin atij mundësinë të sigurojë evidencën e nevojshme të auditimit për të qënë në gjëndje të nxjerrë konkluzione të arsyeshme mbi të cilat të bazojë opinionin e tij.

Përkufizimet

5. Për qëllime të SNA-ve, termat në vijim kanë kuptimet që u janë dhënë si më poshtë:
 - (a) Regjistrat kontabël – Regjistrat e hyrjeve fillestare të kontabilitetit dhe të dhënat shtesë të tilla si ceqet dhe regjistrat e transferimeve të fondeve në mënyrë elektronike; faturat, kontratat; librat e përgjithshëm dhe librat ndihmës; regjistrimet në ditar dhe korrigjime të tjera në pasqyrat financiare, që nuk janë reflektuar në regjistrimet në ditar dhe në regjistra të tilla si tabelat që mbështetin

¹SNA 315 (i rishikuar), *Identifikimi dhe Vlerësimi i Rreziqeve të Anomalisë Materiale nëpërmjet Njohjes së Entitetit dhe Mjedisit të Tij*.

²SNA 570 (i rishikuar), *Vijimësia*.

³SNA 520, *Procedurat Analitike*.

⁴SNA 200, *Objektivat e Përgjithshme të Audituesit të Pavarur dhe Kryerja e një Auditimit në Pajtim me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit*.

⁵SNA 330, *Reagimet e Audituesit ndaj Rreziqeve të Vlerësuar*.

shpërndarjen e kostos, llogaritjet, rakordimet dhe dhëniet e informacioneve shpjeguese.

- (b) Përshtatshmëria (e evidencës së auditimit) – Masa e cilësisë së evidencës së auditimit; që do të thotë rëndësia dhe besueshmëria në dhënien e mbështetjes për konkluzionet mbi të cilat mbështetet opinioni i audituesit.
- (c) Evidenca e auditimit – Informacioni i përdorur nga audituesi për arritjen e konkluzioneve mbi të cilat mbështetet opinioni i tij. Evidenca e auditimit përfshin informacionet që përmbajnë regjistrat kontabël, të cilët përdoren për përgatitjen e pasqyrave financiare dhe informacione e siguruara nga burime të tjera.
- (d) Ekspert i drejtimit – Një individ ose një organizatë që zotëron ekspertizë në një fushë të ndryshme nga kontabiliteti ose auditimi, puna e të cilit në atë fushë është përdorur nga entiteti për ta ndihmuar këtë të fundit në përgatitjen e pasqyrave financiare
- (e) Mjaftueshmëria (e evidencës së auditimit) - Masa e sasisë së evidencës së auditimit. Sasia e evidencës së auditimit që nevojitet ndikohet nga gjykimi i audituesit dhe rreziqet e anomalisë materiale dhe gjithashtu, nga cilësia e kësaj evidence.

Kërkesat

Evidenca e Nevojshme e Auditimit

- 6. Audituesi duhet të përcaktojë dhe të kryejë procedurat e auditimit që janë të përshtatshme për rrethanat, me qëllim që të sigurojë evidencën e nevojshme të auditimit. (Ref: Para. A1–A25)

Informacioni që Duhet të Përdoret si Evidencë Auditimi

- 7. Kur përcaktohen dhe kryhen procedurat e auditimit, audituesi duhet të marrë parasysh përshtatshmërinë dhe besueshmërinë e informacionit që duhet të përdoret si evidencë auditimi. (Ref: Para. A26–A34)
- 8. Nëse informacioni që do të përdoret si evidencë auditimi ka qenë i përgatitur nga puna e një eksperti të drejtimit, sipas nevojës, audituesi do të vlerësojë rëndësinë punës së ekspertit për qëllimet e audituesit. Për këtë ai do të: (Ref: Para. A35–A37)
 - (a) Vlerësojë kompetencën, aftësitë dhe objektivitetin e atij eksperti; (Ref: Para. A38–A44)
 - (b) Sigurojë njohjen dhe të kuptojë punën e atij eksperti; dhe (Ref: Para. A45– A48)

- (c) Vlerësojë përshtatshmërinë e punës së ekspertit si një evidencë auditimi për pohimin përkatës. (Ref: Para. A49)
9. Kur përdoret informacion i prodhuar nga entiteti, audituesi do të vlerësojë nëse informacioni është mjaftueshëm i besueshëm për qëllimet e audituesit, duke përfshirë sipas nevojës e rrethanave:
- (a) Marrjen e evidencës së auditimit mbi plotësinë dhe saktësinë e informacionit; dhe (Ref: Para. A50–A51)
- (b) Vlerësimin nëse informacioni është mjaftueshëm i saktë dhe i detajuar për qëllimet e audituesit. (Ref: Para. A52)

Zgjedhja e Elementeve që duhen Testuar për të Siguruar Evidencën e Auditimit

10. Kur përcakton testet e kontrolleve dhe testet e detajeve, audituesi do të përcaktojë mjetet e zgjedhjes së elementeve që do të testohen, të cilat janë efektive për të përmbushur qëllimin e procedurës së auditimit. (Ref: Para. A53–A57)

Moskoherencë ose Dyshime mbi Besueshmërinë e Evidencës së Auditimit

11. Në qoftë se:
- (a) evidenca e auditimit e marrë nga një burim nuk është në koherencë me atë të marrë nga një burim tjetër; ose
- (b) audituesi ka dyshime mbi besueshmërinë e informacionit që do të përdoret si evidencë auditimi,

audituesi duhet të vlerësojë nëse për të zgjidhur problemin ka nevojë të bëhen modifikime ose shtesa në procedurat e auditimit dhe do të konsiderojë efektin e çështjes, nëse ka të tillë, në aspektet e tjera të auditimit. (Ref: Para. A58)

Zbatimi dhe Materiale të Tjera Shpjeguese

Evidenca e Nevojshme e Auditimit

- A1. Evidenca e auditimit është e nevojshme për të mbështetur opinionin dhe raportin e audituesit. Ajo për nga natyra është kumulative dhe merret kryesisht nga procedurat e auditimit që janë kryer gjatë zhvillimit të auditimit. Megjithatë, ajo mund të përfshijë informacione të marra nga burime të tjera, si për shembull, auditimet e mëparshme (me kusht që audituesi të ketë vlerësuar nëse kanë ndodhur ndryshime që nga auditimi i mëparshëm, të cilat mund të ndikojnë në përshtatshmërinë e evidencës

së auditimit për auditimin aktual⁶) ose nga procedurat e kontrollit të cilësisë të firmës për pranimin dhe vazhdimin e marrëdhënieve me klientin. Përveç burimeve të tjera brenda dhe jashtë entitetit, regjistrat kontabël të entitetit janë një burim i rëndësishëm për evidencën e auditimit. Gjithashtu, informacioni që mund të përdoret si evidencë auditimi mund të jetë përgatitur duke përdorur punën e një eksperti të drejtimit. Evidenca e auditimit përfshin si informacionin që mbështet, ashtu edhe atë që provon pohimet e drejtimit dhe çdo informacion që është në kundërshtim me këto pohime. Përveç kësaj, në disa raste mungesa e informacionit (për shembull, refuzimi nga ana e drejtimit për të dhënë një deklaram të kërkuar), përdoret nga audituesi dhe prandaj, përbën evidencë auditimi.

- A2. Shumica e punës së audituesit në formimin e opinionit të audituesit konsiston në marrjen dhe vlerësimin e evidencës së auditimit. Procedurat e auditimit për të marrë evidencë auditimi mund të përfshijnë inspektimin, konfirmimin, ri-llogaritjen, rikryerjen dhe procedurat analitike, disa herë të kryera në kombinim me njëra-tjetrën, në shtesë të kërkimit të informacioneve. Ndonëse kërkimi i informacioneve mund të japë evidencë auditimi të rëndësishme dhe mund të sigurojë madje evidencë të një anomalie, kërkimi i informacioneve i vetëm, si rregull nuk jep evidencë auditimi të mjaftueshme për mungesën e një anomalie materiale në nivel pohimi dhe as për efektivitetin e funksionimit të kontrolleve.
- A3. Siç shpjegohet në SNA 200⁷, siguria e arsyeshme arrihet vetëm kur audituesi ka marrë evidencën e nevojshme të auditimit për të ulur nivelin e rrezikun e auditimit (që është, rreziku që audituesi të shprehë një opinion të papërshtatshëm kur pasqyrat financiare janë të keqparaqitura materialisht) në një nivel të ulët të pranueshëm.
- A4. Mjaftueshmëria dhe përshtatshmëria e evidencës së auditimit janë të ndërlidhura. Mjaftueshmëria është masa e sasisë së evidencës së auditimit. Sasia e evidencës së auditimit ndikohet nga vlerësimi që audituesi ju bën rreziqeve të anomalise (sa më të larta të jenë rreziqet e vlerësuar, aq më shumë evidencë ka mundësi të kërkohet) dhe gjithashtu, nga cilësia e kësaj evidence të auditimit (sa më e lartë cilësia, aq më pak evidencë mund të kërkohet). Sidoqoftë, marrja e evidencës së auditimit të tepërt nuk mund të kompesojë cilësinë e dobët të saj.
- A5. Përshtatshmëria është masa e cilësisë së evidencës së auditimit; çka do të thotë që ajo është e përshtatshme dhe e besueshme në dhënien e mbështetjes për konkluzionet mbi të cilat bazohet opinionin e audituesit. Besueshmëria e evidencës së auditimit është e influencuar nga burimet dhe nga natyra e saj dhe është e ndërvarur nga rrethanat individuale në të cilat ajo është marrë.
- A6. SNA 330 kërkon që audituesi të arrijë në konkluzionin, nëse është marrë një sasi e mjaftueshme evidence auditimi.⁸ Fakti nëse është marrë evidenca e nevojshme e auditimit për të zvogëluar rrezikun në një nivel të ulët të pranueshëm, dhe për t'i

⁶ SNA 315 (i rishikuar), paragrafi 9.

⁷ SNA 200, paragrafi 5.

⁸ SNA 330, paragrafi 26.

dhënë mundësi audituesit që të nxjerrë konkluzione të arsyeshme, mbi të cilat të bazohet opinioni i tij, është një çështje e gjykimit profesional. SNA 200 përmban trajtime të çështjeve të tilla si natyra e procedurave të auditimit, afatet e raportimeve financiare dhe balancimin ndërmjet përfitimeve dhe kostove, të cilët janë faktorë të rëndësishëm kur audituesi ushtron një gjykim profesional në lidhje me faktin nëse është siguruar evidenca e nevojshme e auditimit.

Burimet e Evidencës së Auditimit

- A7. Një pjesë e evidencës së auditimit është marrë nga kryerja e procedurave të auditimit që shërbejnë për të testuar regjistrat kontabël, si për shembull, nëpërmjet analizës dhe rishikimeve, duke ri-kryer procedurat e realizuara në procesin e raportimit financiar dhe duke rakorduar tipe dhe aplikime të ndryshme për të njëjtin informacion. Nëpërmjet kryerjes së këtyre procedurave të auditimit, audituesi mund të përcaktojë që regjistrat kontabël janë në koherencë dhe në përputhje me pasqyrat financiare.
- A8. Më shumë siguri, zakonisht, arrihet nga një evidencë auditimi që ka koherencë, e cila sigurohet nga burime të ndryshme, ose me një natyrë të ndryshme, sesa nga elementët e evidencës së auditimit të cilët merren individualisht. Për shembull, informacioni konfirmues që vjen nga një burim i pavarur i entitetit mund të sjellë rritjen e sigurisë që audituesi merr nga evidenca e auditimit që është e gjeneruar nga brenda entitetit, siç është evidenca që ekziston në regjistrat kontabël, protokollet e mbledhjeve, apo në një paraqitje të drejtimit.
- A9. Informacioni nga burime të pavaruara prej entitetit që audituesi mund ta përdorë si evidencë auditimi mund të përfshijë konfirmimet nga palët e treta, raportet e analistëve dhe të dhënat e krahasueshme të konkurrentëve (të dhëna krahasimore).

Procedurat e Auditimit për të Siguruar Evidencën e Auditimit

- A10. Siç kërkohet nga, dhe shpjegohet më tej në, SNA 315 dhe SNA 330, evidenca e auditimit për të nxjerrë konkluzione të arsyeshme mbi të cilat të bazohet opinioni i audituesit sigurohet nga kryerja e:
- (a) Procedurave të vlerësimit të rrezikut, dhe
 - (b) Procedurave të mëtejshme të auditimit, që përfshijnë:
 - i. Testet e kontrolleve, kur kërkohen nga SNA-të, ose kur audituesi ka vendosur t'i kryejë ato; dhe
 - ii. Procedurat thelbësore që përfshijnë testet e detajeve dhe procedurat thelbësore analitike.

- A11. Procedurat e auditimit të përshkruara në paragrafët A14- A25 më poshtë, mund të përdoren dhe si procedura për vlerësimin e rrezikut, si teste kontrolli ose procedura thelbësore, në varësi të kontekstit në të cilin ato zbatohen nga audituesi. Siç është shpjeguar në SNA 330, evidenca e auditimit e siguruar nga auditimet e mëparshme mundet që në disa rrethana, të japë evidencë auditimi të përshtatshme kur audituesi kryen procedura auditimi për të vlerësuar përshtatshmërinë e saj edhe në vijimësi.⁹
- A12. Natyra dhe afati i procedurave të auditimit që mund të përdoren ndikohet nga fakti që disa të dhëna të kontabilitetit apo informacione të ndryshme, mund të jenë disponibël vetëm në formë elektronike ose vetëm në disa momente apo periudha të caktuara kohore. Për shembull, dokumentet origjinale, siç janë faturat dhe urdhërat e blerjes, mund të ekzistojnë vetëm në formë elektronike, kur një entitet përdor tregtinë elektronike, ose mund të eliminohen pasi të jenë skanuar kur nje entitet përdor sisteme të përpunimit të imazhit për të lehtësuar ruajtjen dhe referencën.
- A13. Disa informacione në formë elektronike mund të mos jenë më të përdorshme pas një periudhe të caktuar kohe, për shembull, nëse dosjet janë ndryshuar dhe kopjet (backup files) nuk ekzistojnë. Në përputhje me këtë audituesi mund ta konsiderojë të nevojshme, si rrjedhojë e politikave të entitetit për ruajtjen e të dhënave, që të kërkojë ruajtjen e disa informacioneve për tu rishikuar nga audituesit ose që të kryejë procedurat e auditimit në kohën kur informacioni është i disponueshëm.

Inspektimi

- A14. Inspektimi përfshin ekzaminimin e regjistrimeve ose dokumentave, qofshin të brendshëm apo të jashtëm, në letër, në formë elektronike, apo në media tjetër, ose një ekzaminim fizik të një aktivi. Inspektimi i regjistrimeve dhe i dokumentave i siguron audituesit një evidencë mbi shkallët e ndryshme të besueshmërisë, në varësi të natyrës dhe burimit, në rastin e regjistrimeve dhe dokumentave të brendshme, mbi efektivitetin e kontrolleve mbi prodhimin e tyre. Një shembull i inspektimit i përdorur si test kontrolli është inspektimi i regjistrimeve për të marrë evidencë për autorizimin.
- A15. Disa dokumenta paraqesin evidencë auditimi të drejtpërdrejtë për ekzistencën e një aktivi, për shembull, një dokument që përbën një instrument financiar siç është një aksion apo një bono. Inspektimi i këtyre dokumentave jo medoemos siguron një evidencë auditimi rreth pronësisë apo vlerës. Përveç kësaj, inspektimi i një kontrate të ekzekutuar mund të japë evidencë auditimi të përshtatshme për aplikimin e politikave kontabël nga entiteti, si për shembull për njohjen e të ardhurave.
- A16. Inspektimi i aktiveve afatgjata materiale mund të japë evidencë auditimi të besueshme për ekzistencën e tyre, por jo domosdoshmërisht rreth të drejtave dhe detyrimeve të entitetit ose vlerësimit të aktiveve. Inspektimi i elementëve individuale të inventarit mund të shoqërojë vëzhgimin e numërimit të inventarit.

⁹ SNA 330, paragrafi A35.

Vëzhgimi

A17. Vëzhgimi konsiston në mbikqyrjen e një procesi apo të procedurës që kryhet nga të tjerët, për shembull, vëzhgimi nga audituesi i procesit të numërimit të inventarit nga personeli i entitetit, ose i performancës së aktiviteteve kontrolluese. Vëzhgimi jep evidencë auditimi mbi performancën e një procesi apo të një procedure, por është i kufizuar nga momenti kohor kur ai kryhet dhe nga fakti që akti i të qënurit i vëzhguar mund të ndikojë në mënyrën se si procesi apo procedura kryhet. Shiko SNA 501 për udhëzime të metejshme mbi vëzhgimin e numërimit të inventarit.¹⁰

Konfirmimet me të tretët

A18. Një konfirmim me të tretët përfaqëson një evidence auditimi të siguar nga audituesi si një përgjigje e drejtpërdrejtë në formë të shkruar, e dhënë për audituesin nga një palë e tretë (pala konfirmuese), në letër, ose në formë elektronike apo në media tjetër. Procedurat e konfirmimit me të tretët shpesh janë të rëndësishme kur ato adresojnë pohimet që lidhen me disa teprica llogarie dhe elementët e tyre. Megjithatë, konfirmimet me të tretët nuk duhet të aplikohen vetëm në tepricat e llogarive. Për shembull, audituesi mund të kërkojë konfirmimin e kushteve të marrëveshjeve apo të transaksioneve të ndryshme që entiteti ka me palët e treta; kërkesa për konfirmim mund të bëhet për të kërkuar informacione nëse janë bërë modifikime në kontratë dhe po qe se janë bërë, cilat janë detajet e këtyre modifikimeve. Procedurat e konfirmimit me të tretët përdoren gjithashtu, për të siguar evidencë auditimi rreth mungesës së disa kushteve, si për shembull mungesa e “një marrëveshjeje dytësore” që mund të influencojë njohjen e të ardhurave. Shiko SNA 505 për udhëzime të mëtejshme.¹¹

Rillogaritja

A19. Rillogaritja konsiston në kontrollin e saktësisë matematikore të dokumentave apo regjistristreve. Rillogaritjet mund të bëhen në mënyrë manuale ose elektronike.

Rikryerja

A20. Rikryerja përfshin ekzekutimin e pavaruar prej audituesit të procedurave ose të kontrolleve që fillimisht kanë qënë kryer si pjesë të një kontrolli të brendshëm të entitetit.

Procedurat analitike

A21. Procedurat analitike konsistojnë në vlerësimin e informacionit financiar nëpërmjet analizave të marrëdhënive të mundshme që ekzistojnë midis të dhënave financiare dhe jo-financiare. Procedurat analitike po ashtu, përmbledhin investigimet, që

¹⁰ SNA 501, *Evidenca e Auditimit – Konsiderata të Veçanta për Zëra të Zgjedhur*.

¹¹ SNA 505, *Konfirmimet nga të Tretët*.

gjykohen të nevojshme, të fluktuacioneve të identifikuara apo të marrëdhënieve që nuk janë në koherencë me informacionet e tjera, ose që ndryshojnë në shifra të mëdha nga vlerat e pritura. Shiko SNA 520 për udhëzime të mëtejshme.

Kërkimi i informacionit

- A22. Kërkimi konsiston në kërkimin e informacionit financiar ashtu dhe jofinanciar prej personave të mirëinformuar si brenda ashtu edhe jashtë entitetit. Kërkesat përdoren gjerësisht gjatë gjithë auditimit si shtesë për procedurat e tjera të auditimit. Kërkimet mund të variojnë nga kërkesat formale të shkruara deri tek ato jo-formale verbale. Vlerësimi i përgjigjeve për kërkesat përbën një pjesë integrale të procesit të kërkimit të informacioneve.
- A23. Përgjigjet ndaj kërkesave mund ta pajisin audituesin me informacione që nuk kanë qenë zoëruar më parë ose me një evidencë auditimi që konfirmon. Si alternative, përgjigjet mund të japin informacion që ndryshon në mënyrë të konsiderueshme nga informacioni që audituesi ka marrë, për shembull, informacioni lidhur me mundësinë që drejtimi të mund të anashkalojë kontrollat. Në disa raste përgjigjet ndaj kërkesave sigurojnë një bazë që audituesi të modifikojë ose të kryejë procedura auditimi shtesë.
- A24. Edhe pse konfirmimi i evidencës së marrë nëpërmjet kërkesave, shpesh është i një rëndësie të veçantë, në rastin e kërkesave rreth synimeve të drejtimit, informacioni i disponueshëm për të mbështetur qëllimin e menaxhimit mund të jetë i kufizuar. Në këto raste, njohja dhe kuptimi i historisë së shkruar të drejtimit në lidhje me realizimin e pikësnyimeve të vendosura prej tij, arsyet që drejtimit ka zgjedhur një mënyrë të caktuar reagimi dhe aftësitë drejtuese për të ndjekur një veprim të caktuar, mund të japin informacionin e nevojshëm për të provuar evidencën e marrë nëpërmjet kërkesave për informacione.
- A25. Në lidhje me disa çështje, audituesi mund të konsiderojë të nevojshme të sigurojë paraqitje të shkruara nga drejtimi dhe, kur është e përshtatshme, edhe nga personat e ngarkuar me qeverisjen e entitetit, për të konfirmuar përgjigjet ndaj kërkesave verbale. Shiko SNA 580 për udhëzime të mëtejshme.¹²

Informacioni që Duhet Përdorur si Evidencë Auditimi

Përshtatshmëria dhe Besueshmëria (Ref. Para: 7)

- A26. Siç është përmendur në paragrafin A1, ndërkohë që evidenca e auditimit është siguruar kryesisht nëpërmjet procedurave të auditimit të kryera gjatë auditimit, ajo mund të përfshijë edhe informacione të marra nga burime të tjera, si për shembull, nga auditimet e mëparshme në disa raste, procedurat për kontrollin e cilësisë së firmës për pranimin dhe vazhdimin e marrëdhënieve me klientin dhe

¹² SNA 580, *Deklarimet me Shkrim*.

pajtueshmërinë me përgjegjësi të caktuara shtesë sipas ligjit, rregullave dhe kërkesave përkatëse etike (p.sh., në lidhje me papajtueshmërinë e entitetit me ligjet dhe rregullat). Cilësia e të gjithë evidencës së auditimit ndikohet nga përshtatshmëria dhe besueshmëria e informacionit mbi të cilin ajo bazohet.

Përshtatshmëria

- A27. Përshtatshmëria ka të bëjë me lidhjen logjike mes qëllimit të procedurës së auditimit dhe, kur është e përshtatshme, të pohimeve që janë marrë në konsideratë. Përshtatshmëria e informacionit që duhet përdorur si evidencë auditimi mund të ndikohet nga drejtimi i testimi. Për shembull, nëse qëllimi i një procedure është që të testojë mbivlerësimin në ekzistencë apo në vlerësim të llogarive të pagueshme (furnitorëve), testimi i regjistrimeve në llogaritë e pagueshme mund të jetë një procedurë auditimi e përshtatshme. Nga ana tjetër, nëse qëllimi i një procedure auditimi është testimi i nënvlerësimeve në ekzistencë apo vlerësim të llogarive të pagueshme, testimi i llogarive të pagueshme të regjistruara nuk mund të jetë i përshtatshëm, por testimi i informacioneve të tilla si pagesat e mëpasshme, faturat e papaguara, pasqyrat e furnitorëve, dhe raportet e marra të papërputhura mund të jenë të përshtatshme.
- A28. Një grup i dhënë procedurash auditimi mund të sigurojë evidencë auditimi që është e përshtatshme për disa pohime, por jo për disa pohime të tjera. Për shembull, inspektimi i dokumentave që kanë të bëjnë me mbledhjen e llogarive të arkëtueshme (klientëve) pas fundit të vitit mund të japë evidencë auditimi në lidhje me ekzistencën dhe me vlerësimin, por jo domosdoshmërisht në lidhje me paraqitjen në periudhen e duhur (cut – off). Në mënyrë të ngjashme, marrja e evidencës së auditimit në lidhje me një pohim të caktuar, për shembull, për ekzistencën e inventarit, nuk mund të zëvendësojë marrjen e evidencës së auditimit në lidhje me një pohim tjetër, për shembull, vlerësimin e inventarit. Nga ana tjetër, evidenca e auditimit e marrë nga burime të ndryshme apo që është e një natyre të ndryshme, shpesh mund të jetë e përshtatshme për të njëjtin pohim.
- A29. Testet e kontrolleve bëhen për të vlerësuar efektivitetin e funksionimit të kontrolleve për të parandaluar, ose zbuluar dhe korigjuar, anomalite materiale në nivel pohimi. Përcaktimi i testeve të kontrolleve për sigurimin e evidencës së auditimit të përshtatshme, përfshin identifikimin e kushteve (karakteristikave apo cilësive) që tregojnë performancën e një kontrolli, dhe devijimeve në kushte, që tregojnë largimet nga performanca e duhur. Prezenca apo mungesa e këtyre kushteve mund të testohet nga audituesi.
- A30. Procedurat thelbësore kanë si qëllim zbulimin e anomalive materiale në nivel pohimi. Ato përfshijnë testet e detajeve dhe procedurat analitike thelbësore. Hartimi i procedurave thelbësore përfshin identifikimin e kushteve të përshtatshme për qëllimin e testit, të cilat përbëjnë një anomalë në pohimin përkatës.

Besueshmëria

A31. Besueshmëria e informacionit që duhet të përdoret si evidencë auditimi, dhe për këtë arsye, e vetë evidencës së auditimit, influencohet nga burimi dhe natyra e saj dhe nga rrethanat në të cilat ajo është marrë, duke përfshirë, kur është e nevojshme, kontrollet mbi përgatitjen dhe mbajtjen e saj. Prandaj, përgjithësimet rreth besueshmërisë së llojeve të ndryshme të evidencës së auditimit janë subjekt i përjashtimeve të rëndësishme. Edhe kur informacioni që përdoret si evidencë auditimi, është siguruar nga burime nga jashtë entitetit, mund të ekzistojnë rrethana të cilat ndikojnë në besueshmërinë e tij. Për shembull, informacioni i siguruar nga një burim i jashtëm i pavarur mund të mos jetë i besueshem, nëse burimi nuk është i njohur, apo eksperti i drejtimit mund të ketë mungesë objektiviteti. Duke marrë parasysh që ekzistojnë përjashtime, përgjithësimet e mëposhtme në lidhje me besueshmërinë e evidencës së auditimit mund të jenë të dobishme:

- Besueshmëria e evidencës së auditimit rritet kur informacioni është siguruar nga burime të pavaruara jashtë entitetit.
- Besueshmëria e evidencës së auditimit që gjenerohet nga brenda entitetit është më e lartë kur kontrollet e kryera në lidhje me të, duke përfshirë ato në lidhje me përgatitjen dhe mbajtjen e saj, që janë të vendosura nga entiteti janë efektive.
- Evidenca e auditimit e siguruar direkt nga audituesi (për shembull vëzhgimi mbi kryerjen e një kontrolli) është më e besueshme sesa evidenca e auditimit e siguruar në mënyrë indirekte apo e arritur nëpërmjet një konkluzioni (për shembull, kërkesa për informacion në lidhje me mënyrën e kryerjes së një kontrolli).
- Evidenca e auditimit në formë dokumentare, në letër apo në formë elektronike apo në media tjetër është më e besueshme sesa evidenca verbale (për shembull, një regjistrim i njëkohshëm i një takimi është më i besueshëm sesa një paraqitje verbale e çështjeve të diskutuara).
- Evidenca e auditimit e siguruar nga dokumentet origjinale është më e besueshme sesa evidenca e auditimit e siguruar nëpërmjet faksit apo fotokopjeve, apo dokumenteve të filmuara, dixhitalizuara apo të transformuara në formë elektronike, besueshmëria e të cilave mund të varet nga kontrollet për përgatitjen dhe mbajtjen e tyre.

A32. SNA 520 jep udhëzime të mëtejshme në lidhje me besueshmërinë e të dhënave të përdorura për qëllimë të përcaktimit të procedurave analitike si procedura thelbësore¹³.

¹³SNA 520, paragrafi 5 (a).

- A33. SNA 240 trajton rrethanat kur audituesi ka arsye të besojë që një dokument mund të mos jetë i vërtetë, ose mund të jetë modifikuar dhe ky modifikim nuk i është bërë me dije audituesit¹⁴.
- A34. SNA 250 (I rishikuar)¹⁵ jep udhëzime të mëtejshme për sa i takon pajtueshmërisë së audituesit me çdo përgjegjësi shtesë sipas ligjit, rregullave dhe kërkesave përkatëse etike në lidhje me papajtueshmëritë e identifikuarra ose të dyshuara të entitetit me ligjet dhe rregullat që mund të sigurojë informacione të mëtejshme të përshtatshme për punën e audituesit në përputhje me SNA-të dhe vlerësimin e ndikimeve të këtyre papajtueshmërive për sa i takon aspekteve të tjera të auditimit.

Besueshmëria e Informacionit të Përgatitur nga një Ekspert i Drejtimit (Ref: Para. 8)

- A35. Përgatitja e pasqyrave financiare të një entiteti mund të kërkojë ekspertizë në një fushë që është e ndryshme nga ajo e kontabilitetit apo e auditimit, si për shembull, përlllogaritje aktuariale, vlerësime ose të dhëna inxhinierike. Entiteti mund të ngarkojë ekspertë të këtyre fushave për të marrë ekspertizën që nevojitet për përgatitjen e pasqyrave financiare. Nëse entiteti nuk vepron në këtë mënyrë, kur ekspertiza është e nevojshme, rreziku i anomalisë materiale rritet.
- A36. Kur informacioni që do të përdoret si evidencë auditimi është përgatitur nga një ekspert i drejtimit, do të zbatohen kërkesat e paragrafit 8 të këtij SNA-je. Për shembull, një person ose një organizatë mund të zotërojë ekspertizë në aplikimin e modeleve për çmuarjen e vlerës së drejtë të letrave me vlerë për të cilat nuk ekziston një treg i cili mund të studiohet. Nëse personi ose organizata e zbaton këtë ekspertizë për të bërë një një çmuarje të cilën entiteti e përdor në përgatitjen e pasqyrave financiare, personi ose organizata është një ekspert i drejtimit dhe në këtë rast zbatohet paragrafi 8. Nëse, nga ana tjetër, personi ose organizata japin vetëm të dhëna për çmimet në lidhje me transaksione private që nuk janë në dispozicion të entitetit, të cilat entiteti i përdor në metodat e veta të çmuarjeve, këto informacione në se përdoren si evidencë auditimi janë subjekte të paragrafit 7 të këtij SNA-je, por nuk mund të konsiderohen si përdorim i ekspertit të drejtimit nga entiteti.
- A37. Natyra, afatet dhe shtrirja e procedurave të auditimit në lidhje me kërkesat e përcaktuara në paragrafin 8 të këtij SNA-je, mund të ndikohen nga çështje të tilla si:
- Natyra dhe kompleksiteti i çështjes me të cilën ka të bëjë eksperti i drejtimit;
 - Rreziqet e anomalisë materiale në çështjen;

¹⁴SNA 240, *Përgjegjësia e Audituesit për të Marrë në Konsideratë Mashtrimin në një Auditimi të Pasqyrave Financiare*, paragrafi 14.

¹⁵SNA 250 (I rishikuar), *Mbajtja Parasyshe e Ligjeve dhe Rregullave në një Auditim të Pasqyrave Financiare*, paragrafi 9

- Disponibiliteti i burimeve alternative të evidencës së auditimit;
- Natyra, objekti dhe objektivat e punës së ekspertit të drejtimit;
- Fakti nëse eksperti i drejtimit është i punësuar nga entiteti apo është një palë e angazhuar prej tij për të dhënë shërbimet përkatëse;
- Shkalla deri në të cilën drejtimi mund të ushtrojë kontroll ose ndikojë në punën e ekspertit të drejtimit;
- Fakti nëse eksperti i drejtimit duhet të zbatojë gjatë punës së tij standarde të tjera teknike ose kërkesa sektoriale apo profesionale;
- Natyra dhe shtrirja e çdo kontrolli brenda entitetit mbi punën e ekspertit të drejtimit.
- Njohuritë dhe eksperiencia e audituesit për sektorin e ekspertizës të ekspertit të drejtimit;
- Eksperiencia të mëparshme të audituesit në lidhje me punën e ekspertit.

Kompetencat, Aftësitë dhe Objektiviteti i Ekspertit të Drejtimit (Ref: Para. 8(a))

A38. Kompetenca lidhet më natyrën dhe nivelin e ekspertizës të ekspertit të drejtimit. Aftësia lidhet me mundësinë e ekspertit të drejtimit për të zbatuar këtë kompetencë sipas rrethanave. Faktorët që ndikojnë në aftësitë mund të përfshijnë, për shembull, vendndodhjen geografike, disponueshmërinë e kohës dhe të burimeve. Objektiviteti lidhet me efektet e mundshme që ndërhyrjet, konflikti i interesit apo influenca që të tjerët mund të kenë në gjykimin profesional ose në biznesin e ekspertit të drejtimit. Kompetenca, aftësitë dhe objektiviteti i ekspertit të drejtimit, dhe kontrollet brenda entitetit për punën e ekspertit, janë faktorë të rëndësishëm për besueshmërinë e informacioneve të prodhuara nga një ekspert i drejtimit.

A39. Informacionet në lidhje me kompetencën, aftësitë dhe objektivitetin e një eksperti të drejtimit mund të merren nga burime të ndryshme, të tilla si:

- Eksperiencia personale në lidhje me detyrat e mëparshme që ka patur eksperti;
- Diskutimet me këtë ekspert;
- Diskutimet me persona të tjerë që janë të familiarizuar me punën e këtij eksperti;
- Njohja e kualifikimeve të ekspertit, anëtarësia e tij në një organizëm profesional apo një shoqatë sektoriale, licensimi për të ushtruar profesionin, ose forma të ndryshme të njohjes së jashtme;

- Shkrimet ose librat e publikuara nga eksperti;
- Prania e mundshme e një eksperti auditimi për të ndihmuar në mbledhjen e evidencës së nevojshme të auditimit në lidhje me informacionet e përgatitura nga eksperti i drejtimit.

A40. Çështjet që janë të rëndësishme për vlerësimin e kompetencës, aftësive dhe objektivitetit të ekspertit të drejtimit përfshijnë faktin nëse puna e ekspertit duhet të respektojë standarde teknike, apo dispozita të tjera profesionale të sektorit, për shembull standarde etike dhe kërkesa të tjera të lidhura me anëtarësinë në një organizëm profesional apo shoqatë të sektorit, standardet e akreditimit të një organizmi të licencuar, ose kërkesat që imponohen nga ligji apo rregulli.

A41. Aspekte të tjera që mund të jenë të rëndësishme përfshijnë:

- Përshtatshmërinë e kompetencës së ekspertit të drejtimit për çështjen për të cilën puna e tij do të përdoret, përfshirë zonat e ndryshme të specializimit në sektorin e tij. Për shembull një aktuar mund të specializohet në sigurimin e pasurive të paluajtshme dhe sigurimet në rastet e aksidenteve, por ka ekspertizë të kufizuar në përlllogaritjen e pensioneve;
- Kompetenca e ekspertit të drejtimit në lidhje me kërkesat përkatëse kontabël, për shembull, njohja e supozimeve dhe metodave, përfshirë modelet nëse aplikohet, të cilat janë në koherencë me kuadrin e zbatueshëm të raportimit financiar;
- Nëse ngjarje të papritura, ndryshime në kushte, ose evidenca e auditimit e siguruar nga rezultatet e procedurave të auditimit, tregojnë që gjatë kryerjes së auditimit, mund të jetë e nevojshme të rikonsiderohet vlerësimi fillestar i kompetencës, aftësive dhe objektivitetit të ekspertit të drejtimit.

A42. Një gamë e gjerë e rrethanave mund të kërcënojnë objektivitetin, për shembull, kërcënimet e egoizimit, kërcënimet e përkrahjes, kërcënimet e familiaritetit, kërcënimet e vetërishikimit dhe kërcënimet e frikësimit. Masat mbrojtëse mund t'i zvogëlojnë këto kërcënime. Ato mund të krijohen ose nga struktura të jashtme (për shembull nga profesioni i ekspertit të drejtimit, nga dispozitat ligjore dhe rregullatore) ose nga mjedisi i punës i ekspertit të drejtimit (për shembull, nga procedurat dhe politikat e kontrollit të cilësisë).

A43. Edhe pse masat mbrojtëse nuk mund të eliminojnë të gjitha kërcënimet mbi objektivitetin e ekspertit të drejtimit, kërcënime të tilla si frikësimi mund të rezultojnë më pak domethënëse për një ekspert të angazhuar nga entiteti sesa për një ekspert të punësuar nga entiteti, dhe efektiviteti i masave mbrojtëse, siç janë politikat dhe procedurat e kontrollit të cilësisë, mund të jetë më i madh. Duke qenë se kërcënimet ndaj objektivitetit i krijuar nga fakti që eksperti është një i punësuar i entitetit do të jetë gjithmonë i pranishëm, një ekspert i punësuar nga entiteti nuk mund të konsiderohet të jetë më objektiv se sa të punësuarit e tjerë të entitetit.

A44. Për të vlerësuar objektivitetin e ekspertit të angazhuar nga entiteti mund të jetë e rëndësishme të bisedohet me drejtuesit dhe me vetë ekspertin mbi interesat dhe marrëdhëniet që mund të përbëjnë një kërcënim për objektivitetin e tij dhe mbi masat e mundshme mbrojtëse përfshirë detyrimet profesionale që ai duhet të zbatojë, dhe për të vlerësuar gjithashtu, nëse këto masa mbrojtëse janë të përshtatshme. Interesat dhe marrëdhëniet që mund të krijojnë kërcënime mund të përfshijnë:

- Interesat financiare;
- Marrëdhëniet e biznesit apo personale;
- Ofrimi i shërbimeve të tjera.

Sigurimi i Njohjes dhe Kuptimit të Punës së Akspertit të Drejtimit (Ref: Para. 8 (b))

A45. Të kuptuarit e punës së ekspertit të drejtimit përfshin nevojën e të kuptuarit të sektorit përkatës. Audituesi mund të marrë njohuri për sektorin përkatës gjatë kohës në të cilën përcakton nëse ai ka njohuritë e mjaftueshme për të vlerësuar punën e ekspertit të drejtimit apo nëse i nevojitet një ekspert për këtë qëllim¹⁶.

A46. Aspektet e sektorit të ekspertit të drejtimit, të rëndësishme për të kuptuarit nga ana e audituesit përfshijnë:

- Faktin nëse sektori i ekspertit përfshin fusha të specializimeve që kanë lidhje me auditimin.
- Faktin nëse aplikohen standarde profesionale, standarde të tjera ose dispozita ligjore dhe rregullore.
- Supozimet dhe metodat e përdorura nga eksperti i drejtimit dhe nëse këto pranohen apo jo në sektorin përkatës, dhe nëse janë të përshtatshme për qëllime të raportimit financiar.
- Natyrën e të dhënave të brendshme dhe të jashtme që përdor eksperti i drejtimit.

A47. Në rastin e një eksperti të drejtimit të angazhuar nga entiteti, si rregull duhet të ketë një letër angazhimi ose ndonjë lloj tjetër marrëveshje të shkruar ndërmjet entitetit dhe ekspertit. Vlerësimi i kesaj marrëveshje kur sigurohet njohja dhe të kuptuarit e punës së ekspertit të drejtimit, mund të ndihmojë audituesin për të përcaktuar përshtatshmërinë e çështjeve të mëposhtme për qëllime të audituesit:

- Natyra, objekti dhe objektivat e punës së ekspertit;

¹⁶SNA 620 , *Përdorimi i Punës së Akspertit të Audituesit*, paragrafi 7.

- Rolet dhe dhe përgjegjësitë respektive të drejtimit dhe të ekspertit;
- Natyra, afatet dhe shtrirja e komunikimit ndërmjet drejtimit dhe ekspertit, përfshirë formën e raporteve që do të jepen nga eksperti.

A48. Në rastin e një eksperti të drejtimit të punësuar nga entiteti, ka shumë pak të ngjarë të ekzistojë një marrëveshje e shkruar e këtij lloji. Në këto raste, kërkesat për ekspertin dhe për personat e tjerë anëtarë të drejtimit, mund të jenë mënyra më e përshtatshme për audituesin për të marrë informacionet e nevojshme për të realizuar njohtjen dhe të kuptuarit.

Vlerësimi i Përshtatshmërisë së Punës së Ekspertit të Drejtimit (Ref: Para. 8(c))

A49. Kur vlerësohet përshtatshmëria e punës së ekspertit të drejtimit si evidencë auditimi për pohimet përkatëse duhet të mbahen parasysh sa më poshtë:

- Përshtatshmëria dhe arsyeshmëria e rezultateve dhe përfundimeve të këtij eksperti, koherenca e tyre me evidencën tjetër të auditimit dhe fakti nëse këto janë reflektuar drejt në pasqyrat financiare;
- Nëse puna e ekspertit përfshin përdorimin e metodave dhe supozimeve të rëndësishme, përshtatshmëria dhe arsyeshmëria e këtyre supozimeve dhe metodave;
- Nëse puna e ekspertit përfshin një përdorim të madh të të dhënave origjinale, përshtatshmëria, plotësia dhe saktësia e këtij burimi të dhënash.

Informacione të prodhuara nga Entiteti dhe të përdorura nga audituesi (Ref: Para. 9 (a)-(b))

A50. Në mënyrë që audituesi të mbledhë evidencë auditimi të besueshme është e nevojshme që informacioni i prodhuar nga entiteti, i cili është përdorur gjatë procedurës së auditimit, të jetë i plotë dhe i saktë. Për shembull efektiviteti i auditimit të të ardhurave nëpërmjet aplikimit të çmimeve standarde dhe regjistrimit të volumit të shitjeve ndikohet nga saktësia e informacionit për çmimet dhe nga saktësia e plotësia e të dhënave të volumit të shitjeve. Po kështu, nëse audituesi ka si synim të kontrollojë një popullatë (për shembull pagesat) për një karakteristikë të vecantë (për shembull autorizimet) rezultatet e testit do të jenë më pak të besueshme nëse popullata nga e cila janë zgjedhur zërat për testim nuk është e plotë.

A51. Mbledhja e evidencës së auditimit në lidhje me saktësinë dhe plotësinë e informacioneve mund të realizohet njëkohësisht me procedurën e auditimit aktual të aplikuar ndaj informacionit, kur marrja e një evidence të tillë të auditimit përbën një pjesë integrale të procedurës së auditimit në vetvete. Në situata të tjera, audituesi mund të ketë marrë evidencë auditimi në lidhje me plotësinë dhe saktësinë e

informacioneve, duke testuar kontrollet mbi përgatitjen dhe mbajtjen e këtyre informacioneve. Megjithatë në disa situata të tjera, audituesi mund të gjykojë se mund të jenë të nevojshme procedura të tjera auditimi.

A52. Në disa raste, audituesi mund të dojë të përdorë informacionet e përgatitura nga entiteti për qëllime të tjera të auditimit. Për shembull, audituesi mund të dojë të përdorë matjet e performancës për qëllime të procedurave analitike, ose të përdorë informacionet e përgatitura nga aktivitetet e monitorimit të entitetit, si për shembull, raportet e auditimit të brendshëm. Në këto raste, përshtatshmëria e evidencës së auditimit të mbledhur, ndikohet nga fakti nëse informacionet janë mjaftueshmërisht të sakta dhe të detajuara. Për shembull, matjet e performancës të përdorura nga drejtuesi mund të mos jenë mjaftueshëm të sakta për të identifikuar anomalitë materiale.

Zgjedhja e Elementeve që duhen Testuar për të Siguruar Evidencën e Auditimit (Ref: Para. 10)

A53. Një test efikas siguron evidencë auditimi të përshtatshme, deri në shkallën që, së bashku me evidencën tjetër të mbledhur apo që pritet të mblidhet, do të jetë i mjaftueshëm për qëllimin e auditimit. Në përzgjedhjen e zërave për tu testuar, audituesit i kërkohet nga paragrafi 7 që të përcaktojë përshtatshmërinë dhe besueshmërinë e informacionit që do të përdoret si evidencë auditimi. Aspekti tjetër i efikasitetit (mjaftueshmëria) është një çështje e rëndësishme që duhet mbajtur parasysh kur zgjidhen elementet për testim. Metodatat në dispozicion të audituesit për të përzgjedhur zërat që do të testohen janë:

- Përzgjedhja e të gjitha zërave (ekzaminimi 100%);
- Përzgjedhja e zërave të veçantë;
- Zgjedhja e një kampioni.

Mund të jetë e përshtatshme të zbatohet një nga këto metoda, ose një kombinim i tyre, në varësi të rrethanave, për shembull rreziku i anomalisë materiale në lidhje me pohimet që testohen dhe zbatueshmëria dhe efica e metodave të ndryshme.

Përzgjedhja e të Gjithë Zërave

A54. Audituesi mund të vendosë që metoda më e përshtatshme është që të shqyrtojë të gjithë popullatën e zërave që përbëjnë një klasë të transaksioneve apo një teprice llogarie kontabël (ose një shtresë brenda popullatës). Ekzaminimi 100 % nuk ka mundësi të ndodhë në rastin e testeve të kontrolleve, ndërkohë që është më e zakonshme për testet e detajeve. Shqyrtimi i të gjithë zërave mund të jetë i përshtatshëm, për shembull kur:

- Popullata përbëhet nga një numër i vogël zërash me vlera të larta;

- Ekziston një rrezik i rëndësishëm dhe metodat e tjera nuk japin evidencën e nevojshme të auditimit;
- Është e nevojshme shqyrtimi i të gjitha zërave nëse mënyra e përlogaritjes është përsëritëse ose kemi të bëjmë me procese që bëhen automatikisht nga një sistem informativ.

Përzgjedhja e Zërave të Veçantë

A55. Audituesi mund të vendosë të përzgjedhë zëra të veçantë nga popullata. Marrja e këtij vendimi ndikohet nga faktorë në të cilët përfshihet njohja e entitetit nga audituesi, rreziku i vlerësuar i anomalive materiale dhe karakteristikat e popullatës. Përgjedhja subjektive e zërave nga audituesi mund të preket nga rreziku i auditimit pa zgjedhje. Zërat e veçantë mund të përfshijnë:

- *Zëra me vlera të larta ose zëra kyç.* Audituesi mund të vendosë të përzgjedhë zëra të veçantë të një popullate për shkak të vlerës së lartë që ata kanë, për shkak se janë të dyshimtë, jo të zakonshëm, apo janë të rrezikuar, ose në të kaluarën janë gjetur gabime.
- *Të gjithë zërat më të larta se një shumë e caktuar.* Audituesi mund të vendosë të shqyrtojë zërat, vlera e të cilëve kalon një shumë të caktuar, me qëllimin për të verifikuar në këtë mënyrë, pjesën më të madhe të shumës totale të një klase transaksionesh apo tepricash të një llogarie kontabël.
- *Zëra për të mbledhur informacione.* Audituesi mund të shqyrtojë zërat me qëllimin për të marrë sa më shumë informacione mbi aspekte të tilla si lloji i entitetit apo i veprimeve.

A56. Edhe pse përzgjedhja e zërave të veçantë, të një klase transaksionesh apo të tepricës të një llogarie kontabël shpesh paraqet një metodë eficiente për mbledhjen e evidencës së auditimit, ajo nuk përbën një zgjedhje në auditim. Rezultatet e procedurave të auditimit të zbatuara në zërat e përzgjedhur në këtë mënyrë, nuk mund të projektohen në të gjithë popullatën, dhe si pasojë shqyrtimi selektiv i zërave të veçantë nuk përbën evidencë auditimi në lidhje me pjesën tjetër të mbetur të popullatës.

Zgjedhja në Auditim

A57. Zgjedhja në auditim ka si synim arritjen e përfundimeve për të gjithë popullatën në bazë të verifikimit të një kampioni të marrë nga popullata. Zgjedhja në auditim trajtohet nga SNA 530.¹⁷

¹⁷SNA 530, *Zgjedhja në Auditim*.

Moskoherencë ose Dyshime mbi Besueshmërinë e Evidencës së Auditimit

(Ref: Para. 11)

A58. Mbledhja e evidencës së auditimit nga burime të ndryshme apo të llojeve të ndryshëm mund të tregojë pabesueshmërinë e një evidence auditimi si në rastin kur evidenca e auditimit të mbledhur nga një burim nuk është në koherencë me atë të mbledhur nga një burim tjetër. Kjo gjë ndodh, për shembull, kur përgjigjet që audituesi merr gjatë kërkimit të informacioneve janë të ndryshme nga përgjigjet e dhëna nga funksionet drejtuese, audituesit e brendshëm apo subjekte të tjerë, ose kur përgjigjet e marra nga personat e ngarkuar me qeverisjen nuk janë koherencë me ato të dhëna nga drejtuesit. SNA 230 përfshin kërkesa të vecanta lidhur me dokumentimin në rastin kur audituesi ka identifikuar informacione që nuk janë në koherencë me përfundimet në lidhje me një çështje rëndësishme.¹⁸

¹⁸SNA 230, *Dokumentimi i Auditimit*, paragrafi 11.